



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 16 DHE 23 MAJ 2024**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 16. I 23. MAJA 2024. GODINE**

**MAJ - MAJ
2024**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-297 për ratifikimin e Marrëveshjes kornizë ushtarake ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë,
2. Marrëveshja ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e trajtimit të ujërave të zeza në Ferizaj,
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-303 për ratifikimin e Amendamentit të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“Marrëveshja”) - neni 1,
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-301 për ratifikimin e Marrëveshjes për njohjen e kualifikimeve profesionale për infermier, kirurg veterinar, farmacist dhe mami në kontekstin e Marrëveshjes së tregtisë të lirë të Evropës Qendrore,
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-302 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për Projektin “Banimi social adekuat”.

Dnevni red

1. Razmatranje N/zakona br. 08/L-297 za ratifikaciju vojnog okvirnog sporazuma između Vlade Kosova i Vlade Republike Turske,
2. Sporazum između Republike Kosovo i Evropske banke za rekonstrukciju i razvoj za projekat tretmana otpadnih voda u Uroševcu,
3. Razmatranje N/zakona br. 08/L-303 o ratifikaciji Amandmana na Sporazum o osnivanju Evropske banke za obnovu i razvoj (“Sporazum”) - član 1,
4. Razmatranje N/zakona br. 08/L-301 o ratifikaciji Sporazuma o priznavanju profesionalnih kvalifikacija za medicinske sestre, hirurg veterinar, farmaceute i babice u kontekstu Centralnoevropskog sporazuma o slobodnoj trgovini,
5. Razmatranje N/zakona br. 08/L-302 o ratifikaciji sporazuma o zajmu između Republike Kosovo koju predstavlja Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera i Razvojne Banke Saveta Evrope (RBSE) za projekat -adekvatno socijalno stanovanje.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Po e fillojmë këtë seancë të jashtëzakonshme, është dorëzuar nga 44 deputetë.

Në këtë seancë do të trajtohen vetëm dy prej marrëveshjeve, ashtu siç paraprakisht u morën vesh edhe grupet parlamentare, jo të tjerat që ishin në plan.

1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-297 për ratifikimin e Marrëveshjes kornizë ushtarake ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë

Më urgjentja është kjo me Republikën e Turqisë, marrëveshja kornizë ushtarake. Por, fillimisht kërkohet një shmangie për shkak të procedurave. Ua japim fjalën propozuesve të kësaj seance të jashtëzakonshme, a e kemi kryetarin e Grupit Parlamentar të mazhorancës, nuk po e shoh këtu?

Për shqyrtimin e këtyre projektligjeve që janë kërkuar përmes seancës së jashtëzakonshme, të nderuar deputetë, po ju njoftoj që kërkohet shmangie nga procedurat e afateve. Kështu që ia japim fjalën menjëherë zonjës Kusari-Lila që ta arsyetojë propozimin.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Siç e keni marrë edhe informatën, për arsye se ne kishim bashkërisht me grupet parlamentare një konsultim në raport me kërkesën e 44 deputetëve të mazhorancës për një seancë të jashtëzakonshme, në të cilin proceduam kërkesën për 5 marrëveshje ndërkombëtare të reja që kanë kaluar procedurat në shqyrtim në komisionet funksionale.

Megjithatë, në fund dakordanca e përbashkët me grupet ishte që vetëm dy prej tyre të jenë në votim sot në Kuvendin e Kosovës. Duke marrë parasysh rëndësinë dhe peshën e të dy marrëveshjeve dhe gjithashtu domosdoshmërinë e votimit, e para marrëveshje ka të bëjë një marrëveshje kornizë ushtarake ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë. Dhe, e dyta ka të bëjë me një marrëveshje në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtimin dhe Zhvillimin për projektin e trajtimit të ujërave të zeza në Ferizaj.

Në pajtim me nenin 123 paragrafi 1, të Rregullores së Kuvendit kemi propozuar shmangie nga afatet procedurale të përcaktuara me nenin 52, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit për t'u shqyrtuar dy marrëveshjet e lartpërmendura. Andaj, ftoj deputetët e të gjitha grupeve parlamentare që bashkërisht t'i mbështesim dhe ratifikojmë sot në Kuvendin e Republikës këto dy marrëveshje. Faleminderit!

KRYETARI: Kjo fillimisht shkon vetëm me shmangie të Rregullores. Sa deputetë jemi, ju lutem? 87, mirë. E hedhim në votim këtë shmangie të Rregullores.

Kush është për shmangien e Rregullores që t'i trajtojmë këto dy marrëveshje?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Me sa e pashë, 85 deputetë e mbështetën këtë, asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Kështu që konstatoj që Kuvendi i shmangu afatet e procedurave, prandaj hyjmë drejtë e në trajtimin e këtyre lëndëve, pra të këtyre projektligjeve.

Projektligji i parë është dashur të prezantohet nga ministri i Mbrojtjes, por ministrin nuk e kemi këtu në Kosovë, kështu që ai e ka deleguar këtë kompetencë, këtë përgjegjësi te ministri Faton Peci. Epo mirë, po i shkuaka, pra, në rregull.

MINISTRI FATON PECI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit!

E nderuar zëvendëskryeministre Donika Gërvalla!

Kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në emër të Ministrisë së Mbrojtjes paraqes për miratim Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes kornizë ushtarake ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë.

Kjo marrëveshje parasheh bashkëpunimin në këto fusha: Stërvitje dhe edukim ushtarak, industri dhe mbrojtje, shkëmbim të inteligjencës ushtarake, mjekësi ushtarake, operacione paqeruajtëse dhe humanitare kundër terrorizmit e të tjera. Në mënyrë që kjo marrëveshje të hyjë në fuqi në përputhje me dispozitat e Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare, kërkoj të votohet ky projektligj. Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYETARI: Nuk po shoh që dikush dëshiron ta komentojë këtë marrëveshje, kështu që shkojmë drejt në votim. E kemi votimin e kësaj Marrëveshje Kornizë ushtarake mes Turqisë dhe Republikës së Kosovës.

87 qenkemi në sallë, kështu që janë kushtet për ta votuar këtë marrëveshje.

Kush është për këtë marrëveshje ndërkombëtare?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

85 vota i mori kjo marrëveshje në favor. Asnjë votë kundër. Asnjë abstenim. Kështu që konstatoj që Kuvendi e miratoi Ligjin për ratifikimin e marrëveshjes kornizë ushtarake mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë.

Atëherë, e kemi projektligjin tjetër:

2. Marrëveshja ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e trajtimit të ujërave të zeza në Ferizaj

Të nderuar deputetë, Komisioni Funkcional për Buxhet e ka shqyrtuar këtë marrëveshje, na e ka rekomanduar miratimin e saj. Shkojmë e drejt te prezantimi i kësaj marrëveshjeje, e kemi këtu zotin Vitia, meqenëse zoti Murati nuk ndodhet në Kosovë.

MINISTRI ARBEN VITIA: Faleminderit, kryetar!

E nderuar zëvendëskryeministre Gërvalla,

Kabinet qeveritar,

Të dashur deputetë,

Të dashur qytetarë,

Qeveria e Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në kuadër të bashkëpunimit financiar me donatorët bilateral dhe institucione ndërkombëtare financiare, kanë nënshkruar më datën 15 dhjetor 2023, marrëveshjen e kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e trajtimit të ujërave të zeza.

Kjo marrëveshje është negociuar dhe finalizuar në kuadër të përpjekjeve të Kosovës për të avancuar zhvillimin e qëndrueshëm të vendit dhe në linjë me programin e Qeverisë dhe vizionin për infrastrukturë të integruar në harmoni me mjedisin e pastër. Projekti përfshin dy financues: Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Bashkimin Evropian përmes Kornizës së investimeve të Ballkanit Perëndimor. Marrëveshja me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim kap vlerën prej 20 milionë eurove, gjithashtu në kuadër të këtij projekti është dërguar aplikacioni për grant investiv në rundin e fundit të kornizës së investimeve të Ballkanit Perëndimor në vlerë prej 10 milionë eurove që të mbulojë një pjesë të shpenzimeve kapitale për projektin.

Qëllimi i projektit është financimi i ndërtimit të një impianti të ri për trajtimin e ujërave të zeza në Ferizaj, zgjerimi i rrjetit të kanalizimeve dhe financimi i asistencës teknike përkatëse që do t'i ofrohet kompanisë, përkatësisht KRU "Bifurkacioni". Projekti do të ofrojë shërbime të trajtimit të ujërave të zeza përreth 90 mijë banorë në komunën e Ferizajt dhe në komunën e Kaçanikut, si dhe në zonat përreth dhe gjithashtu do të mundësojë shmangien nga dëmtimi i ekosistemeve lokale duke parandaluar ndotjen e burimeve ujore lokale nga shkarkimet e ujërave të zeza të

patrajtuar. Projekti pritet të përfundojë më datën 31 dhjetor 2027. Ju lutem, për miratim, aprovim! Faleminderit!

KRYETARI: Kjo ishte marrëveshja, e hedhim në votim, i kemi kushtet, më duket, jemi mbi 80 ende në Kuvend? 89. E hedhim në votim këtë marrëveshje për trajtimin e ujërave të zeza në Ferizaj.

Kush është për këtë marrëveshje, kush e mbështet këtë marrëveshje të nderuar deputetë?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

80 vota i mori kjo marrëveshje. Asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Kështu që konstatoj që Kuvendi e miratoi marrëveshjen mes Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për projektin e trajtimit të ujërave të zeza në Ferizaj.

Mirë, këtu e ndërpresim këtë seancë të jashtëzakonshme, marrëveshjet e tjera ndërkombëtare i trajtojmë kur ta kemi një moment më të volitshëm në Kuvend.

* * *

E enjte, më 23 maj 2024

Vazhdimi i mbledhjes së jashtëzakonshme, e filluar më 16 maj 2024

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra të Qeverisë,

Po e fillojmë këtë seancë, është në formë të vazhimit nga seanca e mëparshme, po ju kujtohet, vetëm dy marrëveshje ndërkombëtare i votuam nga gjithsej pesë sa ishin, tri na kanë mbetur që t'i shqyrtojmë e t'i votojmë.

E para është:

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-301 për ratifikimin e Marrëveshjes për njohjen e kualifikimeve profesionale për infermier, kirurg veterinar, farmacist dhe mami, në kontekstin e Marrëveshjes së Tregtisë të Lirë të Evropës Qendrore

Të nderuar deputetë, Komisioni Funkcional për Arsim e ka shqyrtuar këtë marrëveshje, na e ka rekomanduar ta miratojmë në Kuvend. Nuk e di pse, a është prezantuar kjo nga ana e ministres apo ende jo?

Ministri Vitia e prezanton këtë marrëveshje.

MINISTRI ARBEN VITIA: Faleminderit, kryetar!

Më lejoni të prezantoj Projektligjin nr. 08/L-301 për ratifikimin e marrëveshjes për njohjen e kualifikimeve profesionale për infermier, kirurg, veterinar, farmacist dhe mami, në kontekstin e Marrëveshjes së tregtisë së lirë të Evropës Qendrore.

Ky projektligj i ka paraprirë miratimit të Ligjit nr. 08/L-216 për ratifikimin e marrëveshjes për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në Ballkanin Perëndimor dhe Ligji 08/L-217 për ratifikimin e marrëveshjes për njohjen e kualifikimeve profesionale të mjekëve, stomatologëve dhe arkitektëve në kontekstin e Marrëveshjes së tregtisë së lirë të Evropës Qendrore të miratuara në Qeverinë e Kosovës më 8 shkurt 2023.

Më 3 nëntor 2022, Republika e Kosovës ka nënshkruar tri marrëveshje në kuadër të procesit të Berlinit, përmes së cilave pritet të jetësohet tregu i përbashkët rajonal. Marrëveshja për njohjen e profesioneve të rregulluara e ratifikuar me Ligjin nr. 08/L-217 për ratifikimin e marrëveshjes për njohjen e kualifikimeve profesionale, në kontekstin e marrëveshjes së tregtisë së lirë të Evropës Qendrore publikuar në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, të datës 15 mars 2023 në Prishtinë, është njëra nga tri marrëveshjet e nënshkruara. Marrëveshjet e nënshkruara, më 3 nëntor në kuadër të procesit të Berlinit midis Republikës së Kosovës, Republikës së Shqipërisë

dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut janë të plotfuqishme nga 1 qershori 2023, ndërsa me palët e tjera me përfundimin e procedurave të brendshme ligjore. Bazuar në direktivat e BE-së 2005-36-ec, për njohjen e kualifikimeve profesionale, kjo marrëveshje u mundëson qytetarëve që në shtetin pritës të ushtrojnë të njëjtin profesion, për të cilin janë kualifikuar në shtetin amë dhe të realizojnë këtë në kushte jo më pak të favorshme se sa qytetarët e shtetit pritës.

Me marrëveshjen për njohjen e kualifikimeve profesionale bëhet e mundur që profesioni i mjekut, dentistit dhe arkitektit të ushtrohet lirshëm në secilin nga gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor. Ministritë përkatëse, të cilat deri më tani kanë kryer apo janë duke kryer funksionin e njohjes së profesionistëve të huaj në koordinim me MASHT-in, janë duke bërë përshtatjet e akteve të tyre juridike në përputhshmëri me kërkesat nga marrëveshjet e Berlinit dhe janë në përfundimin e tyre.

Ministria e Shëndetësisë, Bordi për licencim të profesionistëve të huaj shëndetësorë, ka bërë plotësim-ndryshimin e Udhëzimit Administrativ numër 10/2022 për licencimin e profesionistëve të huaj shëndetësorë, i cili është aprovuar edhe tanimë i publikuar në gazetën zyrtare më 5 janar 2024, si dhe Udhëzimin Administrativ për licencimin e profesionistëve të huaj shëndetësorë dhe është përgjegjëse për njohjen e kualifikimeve profesionale të mjekëve dhe të stomatologëve.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në muajin maj 2023 ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ nr. 07/2023 për procedurën për licencimin e arkitektëve të regjistruar dhe inxhinierëve të regjistruar dhe nënshkrimin e licencave dhe është përgjegjëse për njohjen e kualifikimeve profesionale.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në vitin 2018 në përputhshmëri me direktivat evropiane ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ 12/2018 për parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkallëve të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës dhe është përgjegjëse për profesionet e rregulluara. I njëjti më datën 27 maj 2024 ka kaluar në Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport dhe me mirëkuptim kërkoj votimin tuaj. Faleminderit!

KRYETARI: Kjo ishte marrëveshja e paraqitur nga ana e Qeverisë.

Kush e merr fjalën në emër të Komisionit të Arsimit? A e merrni ju fjalën, zoti Gola?

Kush flet në emër të komisionit, rekomandimi i komisionit?

Nëse jo, mund të shkojmë drejt e në votim.

Besoj që komisioni e ka rekomanduar miratimin e kësaj marrëveshjeje. Nëse po, atëherë dhe ka pasur konsensus. 95 deputetë jemi të pranishëm. Kërkoj që ta votojmë këtë marrëveshjen e tregtisë së lirë të Evropës Qendrore për këto profesione.

Kush është për këtë marrëveshje, të nderuar deputetë?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Vetëm 2 nuk votuan. 93 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Kuvendi e miratoi këtë marrëveshje ndërkombëtare.

Është marrëveshja tjetër në radhë tash, të nderuar kolegë:

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-303 për ratifikimin e amendamentit të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“Marrëveshja”) - neni 1

Komisioni për Buxhet e ka shqyrtuar këtë marrëveshje, na e ka rekomanduar miratimin. E kemi këtu ministrin Murati për ta paraqitur këtë marrëveshje para Kuvendit. Urdhëroni, ministër!

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë të Kabinetit qeveritar,

Sot para jush paraqes një projektligj, i cili mundëson ratifikimin e Amendamentit të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“Marrëveshja”) – neni 1, më saktësisht çfarë bëhet këtu është një dakordim i arritur në kuadër të Bordit të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, i cili ka paraparë që dy nene të ndryshohen në mënyrë që të bëhet zgjerimi i aktivitetit të berzhit edhe në disa shtete të Afrikës Sub-sahariane, si dhe po ashtu t’i jepet mundësia bordit drejtues që të përcaktojë limitet e kapitalit, në mënyrë që kjo të krijojë fleksibilitet më të madh.

Kjo, pra është një ratifikim i cili është i nevojshëm për shkak të amendamentit të marrëveshjes për themelimin e bankës, ngjashëm siç bëhet, ta zëmë, kur shtohet një shtet anëtar i NATO-së dhe që secili shtet ekzistues anëtarë duhet ta ratifikojë, e ngjashmja është edhe këtu. Pra, bëhet fjalë për vetëm një ratifikim të një amendamenti formalisht, i cili është dakorduar në Bordin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Republika e Kosovës si shtet anëtar e ka për obligim që ta ratifikojë edhe në Kuvendin e vet.

Andaj, duke kërkuar mirëkuptimin tuaj, ju kisha lutur si deputetë që të votoni pro këtij ratifikimi, në mënyrë që të përmbushim obligimin tonë si shtet anëtar në BERZH. Faleminderit!

KRYETARI: Komisioni për Buxhet na e ka rekomanduar miratimin e tij, nëse doni ta merrni fjalën, zoti Muja? Kryetari i komisionit!

ARMEND MUJA: I nderuar kryetar, ne e kemi trajtuar këtë amendament në Komisionin për Buxhet dhe besoj që është i nevojshëm dhe ashtu e kemi miratuar dhe i kemi rekomanduar Kuvendit që ta miratojë. Në të njëjtën kohë edhe në emër të grupit e mbështesim.

KRYETARI: E hedhim në votim këtë marrëveshje. Pra, është ratifikimin e Amendamentit të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“Marrëveshja”) - neni 1.

Kush është për këtë marrëveshje, të nderuar deputetë?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

93 vota për i mori kjo marrëveshje. Asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Kështu që konstatoj që Kuvendi e miratoi këtë ligj, i cili e ratifikon pra marrëveshjen për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, neni 1.

E kemi tash një marrëveshje tjetër ndërkombëtare:

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-302 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për Projektin “Banimi social adekuat”

Komisioni për Buxhet e ka shqyrtuar projektligjin, na e ka rekomanduar votimin e tij. Sërish e kemi ministrin Murati ta paraqesë këtë para Kuvendit.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Republika e Kosovës, përkundër që ende nuk jemi anëtar në Këshillin e Evropës, raporte tashmë kemi me Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës dhe në aspekt të thellimit të këtij bashkëpunimi kemi nënshkruar edhe marrëveshjen e fundit, pra që është për financimin e projektit “Banimi social adekuat”.

Qëllimi kryesor i këtij projekti, zhvillimi i sistemit të menaxhimit të banimit social në Kosovë dhe ngritja e numrit të njësive të banimit social në vend. Me këtë rast, marrëveshja përfshin disa komponentë kyçe për arritjen e qëllimit të projektit, përkatësisht marrëveshja përfshin ngritjen e numrit të njësive të banimit social që mund të bëhet duke rinovuar banesat sociale ekzistuese, shndërrimin e ndërtesave ekzistuese në banesa të reja sociale, ndërtimin e banesave të reja të

banimit social, e tjera. Nga kjo komponentë mund të përfitojnë familjet e cënueshme dhe ato me të ardhura të ulëta, të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit.

Po ashtu, përmes qirave të përballueshme mund të përfitojnë edhe familjet me të ardhura të ulëta deri te ato me të ardhura të mesme, të cilat e kanë të vështirë të përballojnë çmimet e tregut për banim dhe kjo në të njëjtën kohë siguron që nuk do të kemi getoizim, pra ka një miks apo përzierje të familjeve me të ardhura në nivele të ndryshme të të ardhurave që të mos krijohet getoizim, pra vetëm familje të varfra të banojnë në një vend, siç edhe kemi parë që nuk funksionon si model në të kaluarën.

Gjithashtu, nga marrëveshja mund të financohet edhe përmirësimi apo rinovimi i shtëpive ekzistuese në pronësi të familjeve të cënueshme dhe atyre me të ardhura të ulëta, në mënyrë që ato të bëhen të përshtatshme për jetesë apo edhe me raste të veçanta edhe ndërtimin e shtëpive të reja për këto shtresa.

Marrëveshja, varësisht nga nevojat e projektit, po ashtu lejon që një pjesë e mjeteve të përdoren për të asistuar komunat dhe Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në zhvillimin e sistemit dhe implementimin e nënprojekteve. Marrëveshja e Kredisë kap vlerën totale prej 25 milionë euro dhe do t'i mundësojë Qeverisë së Republikës së Kosovës që të zhvillojë sistemin e banimit social në vend, të rrisë numrin e njësive të banimit social në raport me numrin e njësive totale dhe të përmirësojë kushtet e jetesës për familjet me të ardhura të ulëta.

Duke e konsideruar rëndësinë e veçantë që ky bashkëpunim dhe ky projekt ka për Republikën e Kosovës, në përputhje me dispozitat ligjore, ju ftoj që ta votoni dhe ta mbështesni me votën tuaj këtë projekt. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetari i komisionit, deputeti Muja!

ARMEND MUJA: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet e ka diskutuar, e ka trajtuar këtë në 2-3 mbledhje dhe pas shumë diskutimeve, e ka miratuar dhe të njëjtin i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë. Në mesin e diskutimeve kryesore ka qenë nevoja e parandalimit të getoizimit, si rekomandim numër një. E dyta ka qenë që pjesëmarrja e komunave në proces të zbatimit dhe po ashtu e treta është harmonizimi me reformën e skemës sociale dhe testin e varfërisë për kategorizimin e familjeve në të ardhmen. Andaj ju kërkohet që të njëjtin ta miratoni.

KRYETARI: Deputetja Eliza Hoxha po dëshiron ta marrë fjalën në emër të Grupit të Partisë Demokratike. Urdhëroni, zonja Hoxha!

ELIZA HOXHA: Faleminderit, kryetar!

Kam nevojë të ngre disa çështje, sepse ne po e trajtojmë një mundësi, Projektligj për kredi për banim social adekuat, përderisa Ligjin për banim social ministri që është këtu prezent nuk e ka sjellë në Kuvend. Draft-ligji ekziston që nga viti 2019, procesi për ligjin po ashtu ekziston në faqen zyrtare të ministrisë, por që ne atë ligj nuk e kemi trajtuar në Kuvend dhe nuk është miratuar.

Dhe, për mua ka shumë rëndësi ta kuptoj se në bazë të cilave kriteret do të bëhet përzgjedhja e familjeve? Në çfarë mënyre do të kooperohet me komunat, të cilat do të jenë bartëse, qoftë të procesit të ndërtimit në situata të caktuara, ose edhe të menaxhimit të stokut të këtyre banesave në një të ardhme kur ato ndërtohen, kur krejt këto kriteret i përcakton Ligji për banimin social?

Unë e kuptoj që ai ligj është bërë në një mënyrë strikte dhe lidhet më shumë me banimin social në idenë e kategorive të varfra dhe jo ndoshta me aspektin e banimit të përballeshëm, mirëpo për 5 vjet nga Qeveria Kurti 1 në Qeverinë Kurti 2, ai ligj të mos silltet këtu dhe të kemi ne sot një debat për një marrëveshje, kredi për banimin social, mendoj se është e paqartë. Paçka se nëpër kuluare të ndryshme kemi dëgjuar se do të themelohet një agjenci. Normalisht që kemi dëgjuar vetëm copëza, sepse këtu s'kemi diskutuar asnjëherë, asnjëherë, as për programin, për procesin që është bërë, e që është proces i nisur nga 2013, kur jemi bërë anëtar të kësaj banke, apo jo?

Dhe, ka hapa të ndryshëm që janë bërë në qeveri të ndryshme dhe që mendoj se është fer edhe për neve si deputetë të këtij Kuvendi që ta kuptojmë se në çfarë forme do të bëhet dhe do të realizohet kjo marrëveshje dhe ky ligj, që sot e keni sjellë këtu për ta votuar. Paçka se në procesin e programit ne mund të shohim që në shkurt të vitit 2022 misioni teknik i CEB-it që ka qenë në Kosovë, ka miratuar, në fakt edhe në janar 2024 ka ritheksuar se do të përkrahen vetëm dy shtylla të kësaj marrëveshjeje. Po e citoj, shtylla 1 - ndërtimi i ndërtesave të reja për banim social, si dhe shtylla 3 - ndërtimi dhe përmirësimi i shtëpive individuale, gjë që e përmendi edhe ministri në fjalën e tij. Por, që tek dokumenti që ne e kemi marrë, te shtojca e ligjit, keni katër komponentë dhe për mua është e paqartë. Është e paqartë se çfarë vërtet do të përkrahë kjo kredi dhe si do të zbatohet kjo kredi? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, i marrim një herë grupet parlamentare, pastaj e keni radhën ju. Lidhja Demokratike, Avdullah Hoti flet në emër të grupit.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Ministra që jeni prezentë,

Është e vërtetë që në këtë marrëveshje e kemi shqyrtuar në Komisionin për Buxhet. Nuk kemi arritur ta shterim komplet debatin atje dhe unë shpresoj që sot dy ministra që janë prezentë do ta marrin fjalën për t'i informuar deputetët për disa prej aspekteve të kësaj marrëveshjeje.

Besoj që problemi kryesor me këtë marrëveshje është kohëzgjatja nga momenti që është iniciuar e deri më tash. Kredia është miratuar në Këshillin Administrativ të Bankës më 18 nëntor 2022, është nënshkruar në janar 2024 nga ministri, janë humbur të gjitha afatet kohore realisht për këtë marrëveshje.

Problem më vete është komponenti i parë, i cili lidhet me mbështetje për banesat me qira, banesat sociale me qira, që synojnë familjet e varfra dhe banesat me qira të përbalueshme, që synojnë grupe të ndryshme me të ardhura që janë të ulëta deri nën mesatare. Do të jetë problem për faktin se në bazë të statistikave, edhe nga edicioni ynë i statistikave, edhe nga institucionet e tjera, tregojnë që diku 93% të qytetarëve banojnë në shtëpi që i kanë në pronësi. Si rezultat do të ketë ndoshta në praktikë problem të implementohet si duhet ky komponent i marrëveshjes.

Tek komponenti i dytë, që nënkupton renovimin e shtëpive ekzistuese në pronësi të familjeve të cënueshme dhe të varfra, unë e kam pak problematike të kuptoj këtë element, sepse janë dy institucione, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe ministria që merret me çështje të kthimit dhe komuniteteve, që kanë buxhete përkatëse për këto dhe kjo çështje është lënë mandej në, tash sipas kësaj marrëveshjeje, në Ministrinë e Infrastrukturës, që mbulon edhe çështjet e ambientit.

Tek vlerësimi i kostos, besoj se këtu është një mish-mash më vete. Ne po marrim kredi 25 milionë euro, buxheti total është 45 milionë euro, nuk janë të reflektuara nëpër pozicionet përkatëse, nëpër institucionet përkatëse, në veçanti tek obligimi i komunave dhe një vërejtje kapitale tek kostot. Janë 11.1% janë kosto administrative të menaxhimit të projektit dhe paga të ndryshme, ndërkohë që, në veçanti, ministri i Financave ka qenë vazhdimisht kritik për marrëveshjet që kemi ratifikuar në këtë Kuvend, për pjesën që ka shkuar kryesisht për menaxhim të projekteve.

Tek kalendari i punimeve, që lidhet me atë që thashë në fillim, që është ratifikuar kredia në nëntor 2022, nuk është nënshkruar deri në janar 2024, tani jemi në maj 2024, pra janë humbur gati një vit e gjysmë. Pra, duhet të rishikohet tash komplet kalendari i aktiviteteve që parasheh 2023 - 2031.

Tek veprimet paraprake, këtu është besoj problemi më i madh, se nuk është ndërmarrë asnjë veprim paraprak për t'u përgatitur për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, pra te kushtet specifike. Prapë po lidhet me insistimin e madh të ministrit të Financave në marrëveshjet paraprake për përgatitjet që duhet të bëhen, në mënyrë që marrëveshjet të zbatohen me kohë e të mos marrim

kredi e të paguajmë, të bëjmë pagesa të ndryshme për ato kredi, pa filluar ende të zbatohet projekti. Dhe, lidhet edhe me diskutimin që ishte nga përfaqësuesja e PDK-së me mungesën e miratimit të Ligjit për banim social, i cili as nuk është miratuar dhe nuk e di që është në plan për miratim gjatë kësaj legjislature.

Tek prokurimi, edhe këtu nuk janë bërë përgatitjet e nevojshme, sepse në faqen 33 thuhet qartë që duhet të merren parasysh sigurisht kriteret e Ligjit të prokurimit të Kosovës, po sa janë në përputhje ato me procedurat që i ka banka dhe eventualisht nevojën që mund të kemi për rishikim të procedurave të prokurimit për të zbatuar këtë marrëveshje.

Pra, problemet kryesore me këtë marrëveshje janë që, në fakt fundamentale është që ne po marrim kredi, në vend se të zbatohet buxheti i rregullt. Shkalla e realizimit të projekteve të ndryshme është shumë e ulët. Kjo kredi, bashkë me nja dy a tri të tjera që i kemi shqyrtuar, disa prej tyre i kemi rrëzuar e disa kanë arritur të ratifikohen në këtë Kuvend, si rrallë ndonjëherë në të kaluarën, përveç kredive që kemi marrë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar për mbështetje buxhetore, nuk kemi marrë kredi për skema sociale dhe për çështje të tilla. Sepse, shikoni, në fund të fundit, një qeveri që s'mund t'u dalë zot pagesës së ndihmave sociale dhe përmirësimit të kushteve të qytetarëve, të familjeve në nevojë, për çfarë zhvillimi jemi duke bërë fjalë.

Unë e kuptoj që kemi nevojë për asistencë teknike për të avancuar kriteret në këtë drejtim, por të marrim kredi për dhjetë vjetët e ardhshme për t'i përmirësuar kushtet e banimit të disa familjeve në asistencë sociale, ndërkohë që dy ministritë e japin buxhetin, është edhe pa procedura të prokurimit, siç ka ndodhur në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, është pak e pakuptueshme.

Plus këto vërejtjet që i kemi thënë në komision, disa u thanë edhe këtu, për problemet që do t'i shfaqë në praktikë kjo marrëveshje tek getoizimi i njerëzve, mungesa e koordinimit ekzistues me komunat, se si do të shpërndahen këto mjete dhe si do të identifikohen familjet që potencialisht mund të përfitojnë.

Unë shpresoj që dy ministrat do të japin sqarimet e nevojshme për deputetë, në mënyrë që të shohim qëndrimin tonë përfundimtar si grup parlamentar lidhur me këto marrëveshje. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, po ia japim fjalën drejt ministrit të Mjedisit dhe Infrastrukturës. Liburn Aliu flet.

MINISTRI LIBURN ALIU: Faleminderit, kryetar!

Në lidhje me kategoritë, i kemi dy kategori të ndërtimeve, janë ndërtimet e reja dhe renovimi i stokut ekzistues të banimit ekzistues që e kemi. Duke pasur parasysh që në vendin tonë 75% të

ndërtimeve janë pa leje, një ndër problemet ka qenë që këto ndërtimet pa leje kryesisht janë të papërfunduara plotësisht dhe kanë nevojë që të investohet në to dhe zakonisht familjet që janë në skema sociale dhe janë në nevojë kanë nevojë që t'u ndihmohet që të rregullohet jeta, cilësia e jetës, në banimin ekzistues që është aty. Kjo nënkupton renovimin e shtëpive ekzistuese, por të cilat, një pjesë e madhe e tyre janë edhe pa leje.

Si rezultat, në funksion të kësaj kemi bërë edhe ndryshimet e nevojshme në Udhëzimin Administrativ që renovimet brenda shtëpive, të cilat nuk prekin konstruksione, nuk kanë nevojë të marrin leje ndërtimore dhe po ashtu, për përmirësimin e performansës energjetike në këto objekte nuk ka nevojë të merret leje ndërtimore. Dhe rrjedhimisht, edhe mund të financohen drejtpërdrejt këto objekte, pra ndërtime pa leje, shtëpitë individuale, për raste sociale, në të cilat rregullohet performansa energjetike, pra ngrohja dhe renovimet e tjera që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarëve në këto objekte.

Për sa i përket shpërndarjes, ne kemi bërë një thirrje për komunat që të identifikojnë të gjitha lokacionet e tyre, ku do të mund të ndërtohet banimi social dhe i përballueshëm. Mënyrën se si do të ndodhë shpërndarja është e lidhur drejtpërdrejt me Ministrinë e Financave, varësisht prej kategorive sociale. Pra, janë pesë kategori sociale që do të jenë përfituese dhe të cilave do t'u sigurohet qiraja e nevojshme e përballueshme. Është kategoria e parë shumë e varfër, kategoria e dytë – të varfër dhe të cenueshëm, kategoria e tretë me të hyra të ulëta, kategoria e katërt me të hyra të ulëta mesatare dhe kategoria e pestë - të hyra mesatare.

Kur flasim për banimin social, e kemi parasysh që ky stok i banimit do të jetë përherë në pronësi të shtetit, respektivisht të komunave që do të menaxhojnë me banimin social. Banimi social më shumë do të jetë në menaxhim të komunave, në ndërkohë që banimi i përballueshëm është banimi që përfundon në pronësi të pronarëve të rinj dhe nënkupton rastet e kategorive të mesme të punëtorëve të administratës dhe të atyre që kanë pagat, me të cilat nuk mund të sigurojnë banimin e nevojshëm.

Për sa i përket ligjit, pikërisht për shkak se kemi edhe banimin, kategorinë e banimit të përballueshëm, është dashur të bëjmë ndryshimin e nevojshëm të ligjit dhe ta sjellim së shpejti në Kuvend tash, sepse e kemi përfunduar draftin, i ka kaluar edhe pjesën e shqyrtimeve e diskutimeve publike dhe do të vijë brenda këtij viti. Jemi në fazën e përmbylljes së tij, në mënyrë që të kalohet duke e siguruar këtu edhe mundësinë e banimit të përballueshëm.

Çka do të ketë, cila do të jetë zgjidhja e shpërndarjes dhe eliminimit të getove, që ju e përmendët? Natyrisht, se kjo ka qenë një ndër problematikat dhe temat e para themelore të diskutimit, eliminimi i getove që na ka ndodhur në të kaluarën. Banimi social do të jetë, e para - i kombinuar me banimin e përballueshëm, e po ashtu do të jetë edhe i kombinuar brenda lagjeve ekzistuese të banimit. Si komponentë tjetër, si ministri jemi duke shqyrtuar mundësitë që në

zhvillimet e ardhshme në zonat që do të ketë zhvillime të ndërtimit të mund banimi social dhe i përballueshëm të inkorporohet brenda ndërtimeve ekzistuese, ose në ndërtime të reja të jetë i përfshirë përmes bonuseve ndërtimore.

Për sa u përket këtyre ndërtimeve do të jenë brenda lagjeve të projektuara dhe të planifikuara të komunave, ku ka banim ekzistues, dhe nuk do të jetë vetëm banim social, por do të jetë i kombinuar me banimin e përballueshëm. Këtë ftesë ua kemi bërë komunave, pothuajse të gjitha komunat kanë aplikuar, në një mënyrë na i kanë sjellë dokumentacionet për lokacionet e përzgjedhura, në të cilat kërkojmë, e para - cilat janë kriteret sipas planeve hapësinore, dokumentet e planifikimit hapësinor, harqet zonale, apo planeve rregulluese urbane me ligjin e vjetër, cilat janë qasjet në infrastrukturë, cila është marrëdhënia me lagjet e banimit rreth e përqark dhe me komunat pastaj do të diskutohet edhe raporti i banimit të përballueshëm dhe banimit social.

Një pjesë e banesave do të jenë banim social dhe do të jenë në menaxhim të drejtpërdrejtë të komunës, një pjesë tjetër do të jenë banim i përballueshëm, ku bashkë me komunat do të bëhet përzgjedhja e rasteve të personave të kategorive që punojnë në administratë, ose persona me rroga mesatare, qoftë edhe në sektorin privat, që do të mund të aplikojnë dhe të fitojnë banesat me çmim të përballueshëm.

U përpoqa të jap një mendim, për sa i përket anës së banimit.

KRYETARI: Kërkoj një konsultim shumë të shpejtë mes grupeve parlamentare për këtë marrëveshje dhe pastaj për njëzet sekonda vazhdojmë. A e hedhim në votim apo nuk e hedhim në votim fare.

Megjithatë, po e hedhim në votim këtë marrëveshje, e shohim nëse kalon.

Uluni deputetë, tash po votojmë. Uluni, ju lutem!

A mund ta dimë sa jemi, a jo? Ka shumë deputetë në këmbë. Ju lutem, të gjithë ju që jeni në këmbë, uluni ju lutem. edhe atje në fund janë tre deputetë në këmbë që po rrinë.

A e doni edhe një herë fjalën z. Hoti? Urdhëro!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Unë e dhashë qëndrimin e grupit tonë parlamentar dhe kërkoja plot sqarime. Vullneti i grupit parlamentar është që ta mbështesim këtë marrëveshje. Debati për këtë marrëveshje nuk është shteruar plotësisht në Kuvend dhe jemi dakorduar në komision që të vijë këtu në Kuvend. Nëse doni ta kaloni veç proforma, në fund të fundit edhe ju mbështesim këtu.

Unë e bëra një listë të gjatë të pyetjeve. Tani ministri doli na ngatërroi edhe me atë që edhe shërbyesit civilë do të marrin e do të përfitojnë prej kësaj. Po, këtu në projekt nuk shkruan për atë. Janë familjet në asistencë sociale dhe njerëzit që kanë të ardhura të ulëta nën mesataren. Ti nuk e gjen një shërbyes civil që ka të ardhura nën mesatare. Le të bëhemi seriozë kur i diskutojmë këto gjëra që janë vërtet rëndësishme për plot familje.

KRYETARI: I japim edhe një herë fjalën ministrit Aliu.

MINISTRI LIBURN ALIU: Unë shumë i qartë isha, tash.

KRYETARI: Qetësi, se edhe mund të mos dëgjojmë mirë.

MINISTRI LIBURN ALIU: Unë shumë qartë e thashë, kur flasim për banimin social, janë kategoritë sociale ato që përfitojnë. Banimi social është përherë në pronësi të shtetit dhe menaxhojnë komunat me banimin social, monitorohen nga niveli qendror. Varësisht prej kategorive sociale, janë edhe përfituesit e banesave. Përfituesit e banesave sociale nuk bëhen pronarë të banesave sociale, po përfitojnë në periudhën sa ata janë si kategori sociale. Në momentin që dalin nga kategoria sociale, ata më nuk mund të jenë përfitues të banimit social.

Cila janë kategoritë që përfitojnë? Janë pesë kategori: kategoria shumë e varfër, kategoria e të varfërve dhe të cenusëshëm me të hyra të ulëta, me të hyra të ulëta mesatare dhe të hyra mesatare. Kur folëm për shpërndarjen e banimit, janë komunat ato të cilat aplikojnë me lokacione konkrete brenda zonave urbane dhe analizohen marrëdhëniet e këtyre lokacioneve me zonat e banimit përreth, me infrastrukturën të cilën e kanë. Pse? Pikërisht për ta evituar mundësinë e getos që ka pasur raste në të kaluarën.

Dhe, për ta përmirësuar edhe më tej këtë gjendje, për të mos qenë pra edhe një ndërtesë brenda një lagjeje, se në fund të fundit edhe një ndërtesë e vetme me banim social brenda një lagjeje mund të jetë një lloj getoje, edhe brenda saj e kemi planifikuar kombinimin me banimin e përballueshëm.

Këtu e shtova elementin tjetër, pra banimi i përballueshëm është banimi i cili përfundon si pronë e pronarëve të rinj, i cili nuk shkon me këtë kredi, shkon me buxhetin e Republikës së Kosovës, dhe i cili prapë është kërkuar nga komunat që të aplikojnë edhe për banimin e përballueshëm, ku këto objekte, ndërtime të reja po flas do të jenë të kombinuara: banim social dhe banim i përballueshëm. Pra, rastet sociale brenda lagjeve ku ka banime të rregullta dhe do të jenë me banim të përballueshëm që do të jenë kategoritë e shërbyesve civilë, do të jenë kategoritë madje edhe nga sektori privat që pagat e tyre janë të kufizuara.

Cili do të jetë ky lloj i banimit? Do të ketë subvencionim në një mënyrë të kështit të tyre, që ata të arrijnë ta bëjnë pagesën e banesës me një të themi gati si qira të zakonshme brenda pesëdhjetë muajve apo brenda një periudhe edhe më të gjatë. Faleminderit!

KRYETARI: Një pyetje e ka znj. Hoxha për ministrin dhe Qeverinë.

ELIZA HOXHA: Për ministrin Aliu.

Na e sqarove për kategorinë e banimit sociale, d.t.th. të kategorive që nuk janë pronarë, nuk bëhen pronarë. Mua po më intereson ta di, toka në të cilën do të ndërtohen këto ndërtesa është tokë publike që e japin komunat a po? kategoria tjetër e banimit të përballueshëm, për të cilën folët shumë më pak, më intereson ta di a do të shiten këto banesa. D.m.th. ata bëhen pronarë të banesave që komuna dhe kjo kredi i investon në tokë publike.

KRYETARI: Ia japim mundësinë edhe një herë ministrit Aliu për sqarime shtesë, sepse kjo u ndihmon deputetëve.

MINISTRI LIBURN ALIU: Keni plotësisht të drejtë.

Kjo është çështja e diskutimit të banimit të përballueshëm. Pra, cili do të jetë rregullimi pronësisë, sepse do të ndërtohet, po pra pajtohem plotësisht. Prandaj, kur të vijë në ligj, një draftligj, i cili do ta trajtojë edhe banimin e përballueshëm, një ndër pikat kryesore e cila vazhdon të jetë temë e diskutimit është çështja e pronësisë të banimit të përballueshëm. A do të jetë 99 vite siç e parasheh ligji, apo si do të rregullohet çështja e pronësisë.

Prandaj, nuk mund të ketë banim të përballueshëm dhe ndërtim i cili kalon në pronë private pa u rregulluar çështja ligjore e pronësisë në to.

Kjo patjetër që rregullohet, po këtu ju duhet ta keni parasysh, këtë që po e votoni sot, nuk është banim i përballueshëm, është banim social. Ju mund të mos e votoni, është çështja e juaj, po me këtë ligj sot po e votoni banimin social, të cilin edhe e kemi të rregulluar me ligj ne sot.

Pra, çështja e banimit social dhe çështja e menaxhimit të banesave nga ana e komunave, është e rregulluar me ligj. Ligji i ri do ta përmirësojë, por jo që ligji ekzistues të bëhet pengesë për këtë. pra, ju nëse nuk e votoni, është çështje tjetër, po sa i përket banimit të përballueshëm, kur të vijë ligji e rregullon edhe atë kategori, atë e kemi projekt në veti. Për këtë, jemi në rregull në kuptimin edhe me ligjin, edhe me banimin social.

KRYETARI: Mendoj që duhet të shkojmë në votim, megjithatë.

Uluni deputetë! Të shikojmë se sa jemi. Po!

ELIZA HOXHA: Ministër,

Po flas për shtojcën që na ka ardhur neve për këtë ligj, e cila në komponentin e banimit social adekuat, pika 3 thotë: ndërtimi i ndërtesave të reja të banimit social me kosto të përballueshme. Kështu thotë shtojca. Nuk e kam bërë unë këtë, ju e keni sjellë. Këtu është anomalia që unë e ngrita edhe më herët. Prandaj, mendoj si kolegu im atje nga Lidhja Demokratike që ky debat është dashur të bëhet më i gjerë dhe më i sinqertë, për ta kuptuar ne në thelb se çfarë vërtet përbën kjo kredi dhe ku shkojnë këto para.

KRYETARI: E fundit nga ana e ministrit, sepse vërtet duhet të hyjmë në votim.

MINISTRI LIBURN ALIU: Unë edhe një herë po e them qartë, çështja e banimit të përballueshëm është projekt i cili ndërtohet dhe financohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Në kuadër të Marrëveshjes me CEB që e kemi, është në mënyrë shumë të qartë të ndara kategoritë e banimit social, ndërtesa të reja të banimit social dhe e kemi kategorinë tjetër, është renovimi i shtëpive ekzistuese. Aty ku është e rregulluar pronësia, mund të bëjmë renovime. Nuk ka banim të përballueshëm, apo ndërtesa të banimit të përballueshëm. Kostoja e ndërtimeve është diçka tjetër.

Pra, banesa që hyn në banimin e përballueshëm, i cili përfundon në pronësi të pronarëve të rinj, ajo do të rregullohet me ligjin e ri dhe do të jetë me buxhet të Republikës së Kosovës. Këtu kemi të bëjmë me banimin social. Stoku i ndërtimit të banimit social do të jetë në pronësi të shtetit dhe do të menaxhohet nga institucionet shtetërore. Kryesisht, ato do të jenë të nivelit lokal, ndërsa niveli qendror do ta ketë aspektin e monitorimit dhe ndërlidhjes mes kategorive sociale përmes dy ministrive, të Ministrisë së Financave që i ka kategoritë sociale brenda saj dhe të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës që e ka banimin në kuadër të saj.

KRYETARI: Sa deputetë jemi, ju lutem? 90 jemi. Uluni!

Mund t'i bini edhe ziles pak.

A jemi gati tash? Grupet parlamentare, ju lutem! uluni! 94 a po? A 94 a 95? 94.

Uluni! 94 deputetë.

Të nderuar deputetë,

Kush e voton këtë marrëveshjen ndërkombëtare për banim social?

Kush është kundër?

Më fal, znj. Reshitaj, për ta sqaruar votën tënde, çka ishte? E llogaritni edhe atë, pra, sepse 94 jemi shumë pranë, nuk dihet a janë tetëdhjetë a jo.

80 vota po dalin për, por nëse doni e provojmë edhe një herë. 80 vota për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim, kështu që kalon marrëveshja për banimin social adekuat.

Mirupafshim në seancën e radhës!

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë